	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT:

DPS/KT 160 “Pajisje Mbrojtëse Personale”

A Historiku

DPS/KT 160 është krijuar në 14.05.2007, në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare kryesisht për pajisjet mbrojtëse personale në vendin e punës, pajisjet e shpëtimit, pajisjet mbrojtëse të fytyrës, veshjet mbrojtëse ndaj rreziqeve kimike, veshjet mbrojtëse ndaj të ftohtit, dorezat mbrojtëse, pajisjet dhe linjat e sigurisë për përdorim në varkat sportive. Një rëndësi e veçantë në këtë KT i jepet standardeve të harmonizuara të cilat janë nën Rregulloren Nr. 2016/425 “Pajisje Mbrojtëse Personale”.

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme


Puna e DPS/KT 160 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të politikave ekonomike, teknike si dhe për shkak të përdorimit të standardeve në këtë sektor të industrisë i cili lidhet ngushtë me qëllimin e këtij KT. Përveç të tjerave standardet e adoptuara nga ky KT sigurojnë një nivel të lartë mbrojtës për të gjithë prodhuesit dhe përdoruesit. Pjesa më e madhe e standardeve të adoptuara nga ky KT janë standarde të harmonizuara nën Rregulloren nr. 2017/746 të Këshillit Evropian (KE). Në kuadrin e përmbushjes së detyrimeve për anëtarësim në CEN/CENELEC dhe duke u bazuar edhe në strategjinë e DPS është e detyrueshme për ne adoptimi 100% i standardeve nën këtë rregullore.

B.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga DPS/KT 160 dhe palët e interesit të përfshira direkt në procesin e standardizimit brenda këtij KT janë prodhuesit, industria e pajisjeve mjekësore, laboratorët e testimit, autoritetet qeveritare të sigurisë, dhe konsumatorët.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë:

- përmirësimin e cilësisë së pajisjeve mbrojtëse, veshjeve mbrojtëse;
- kontrollin e prodhimit të pajisjeve mbrojtëse personale;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;
- projektimin, dhe prodhimin e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.
- të fitojnë besimin e konsumatorëve dhe përdoruesve.

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 2/3

C Përfitimet

Puna e DPS/KT 160 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- të ndihmojnë prodhuesit e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale në cilësinë e këtyre pajisjeve dhe në përmbushjen e kërkesave themelore në zbatim të Rregulloren nr. 2016/425 të Këshillit Evropian (KE);
- përmbushjen e kërkesave thelbësore për sigurinë dhe performancën e pajisjeve mbrojtëse dhe veshjeve personale;
- zhvillimin dhe hartimin e standardeve për metodat e provës dhe kërkesat përkatëse për pajisjet mbrojtëse personale në lidhje me përmirësimin e performancës së produkteve;
- krijimin e një strukturë gjithëpërfshirëse standardesh, duke marrë parasysh standardet evropiane dhe ndërkombëtare të haruara nga Komitetet Teknike (KT) të tjera;
- ofrimin e informacionit më të mirë për përdoruesit në lidhje me sigurinë dhe shëndetin;
- lehtësimin e zbatimit të standardeve nga të gjitha palët e interesuara;
- promovimin e aktiviteteve të mëtejshme në standardizimin ndërkombëtar.

D Pjesëmarrja në DPS/KT 160

Në DPS/KT 160 ka përfaqësues nga institucione publike, subjekte private, Laboratori i Ushtrisë, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si dhe nga Laboratore private të akredituara të cilat merren me kontrollin e cilësisë dhe prodhimin e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale duke siguruar kështu që përdoruesit të kenë veshje dhe pajisje të sigurta. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

E Objektivat dhe strategjitë

E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT 160

- Një ndër objektivat kryesore të DPS/KT 160 është miratimi i standardeve, në përputhje me përmirësimin e performancës së pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse, përparimin e teknologjive të reja lidhur me prodhimin e këtyre pajisjeve, si dhe metodave të testimit dhe kërkesave thelbësore të pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale, procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, që mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;
- Rishikimin e standardeve ekzistuese evropiane dhe ndërkombëtare nëse teknologjia përparon;
- Trajtimin e aspekteve mjedisore në standardet brenda fushëveprimit të këtij KT, nëse do të jetë nevoja;
- Zhvillimi i një niveli të lartë të standardeve të sigurisë dhe cilësisë të cilat janë shumë të rëndësishme për përdoruesit.

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 160 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:



Emri i institucionit:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Dokumenti Nr.:

RC/DS/117

Titulli:

Plani strategjik i biznesit për DPS/KT

Versioni:

01

Faqe Nr.:

Faqe 3/3

CEN/TC 85	Pajisjet mbrojtëse të syve;
CEN/TC 158	Mbrojtësit e kokës;
CEN/TC 159	Mbrojtësit e dëgjimit;
CEN/TC 160	Pajisje personale për mbrojtjen ndaj rënieve nga lartësitë;
CEN/TC 161	Mbrojtëset për këmbët dhe shputat e këmbëve; Veshje mbrojtëse duke përfshirë mbrojtjen e duarve dhe krahëve dhe jelekët e shpëtimit;
CEN/TC 162	
ISO/TC 94	Siguria personale-Pajisjet mbrojtëse personale;
ISO/TC161	Kontrollet dhe pajisjet mbrojtëse për gazin ose vajin;
ISO/TC185	Pajisjet e sigurisë për mbrojtjen nga presioni i tepërt.

DPS/KT 160 do të sigurojë mirëmbajtjen e nevojshme të standardeve si dhe rishikimin e standardeve të, pranishme nën Rregulloren Nr. 2016/425 të KE.

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

Sekretari i DPS/KT 160

(Elona TELULI)